



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Statistikat e Mirëqenies Sociale Qershor 2022

Korrik, 2022

Prishtinë, 25.07.2022 Bazuar në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare 2022 “Statistikat e Mirëqenies Sociale” publikimi në baza tremujore ka kaluar në baza mujore dhe do të vazhdoj si publikim i rregullt mujor. Ky publikim përmban të dhëna për: skemën e ndihmës sociale, pensionet bazë, pensionet kontribut paguese, pensionet e personave me aftësi të kufizuara, skemën për mbështetje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, skemën për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranët e luftës, skemën e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), skemën e pensioneve të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK), skemën e pensioneve të Minatorëve të Trepçës, skemën për personat e verbër, të dhënat për numrin e fëmijëve të braktisur, numrin e personave të vendosur në shtëpitë për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, numrin e personave me aftësi të kufizuara të vendosur në institutin special të Shtimes si dhe në shtëpitë e komunitetit etj.

Burim i këtyre të dhënave është Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) përkatësisht departamentet në vijim: Departamenti i Politikave Sociale dhe i Familjës, Departamenti i Pensioneve dhe Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës (DFDIL), të cilët i falënderojmë për bashkëpunim.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim mund t’i dërgoni në adresën elektronike infoask@rks-gov.net.

Publikimin përgatitën:

Avni Kastrati - Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale
Naime Rexhepi - Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave Sociale
Mirvete Fazliu - Zyrtare e lartë e Statistikave tjera Sociale

Z.v. i Kryeshefit Ekzekutiv i ASK-së,
Ilir T. Berisha

Për t’u konsultuar me publikime të tjera, vizitoni faqen e ASK: <http://ask.rks-gov.net>

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MFPT	-	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
DFDIL	-	Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës
PPAK	-	Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara
SHPMPF	-	Shtëpitë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare
ISSH	-	Instituti Special i Shtimes
TMK	-	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
FSK	-	Forcat e Sigurisë së Kosovës
DPSF	-	Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes

Simbolet

:	-	Mungojnë të dhënat
-	-	Nuk ka dukuri

Përmbajtja

	Faqe
Shpjegime metodologjike	4
Shuma e pagesës mujore për të gjitha kategoritë e skemës së DFDIL është si në vijim:	7
Tab. 1: Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas komunave	10
Tab. 2: Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas komunave	11
Tab. 3: Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas kategorive	12
Tab. 4: Pensionet bazike të moshës sipas komunave	13
Tab. 5: Pensionet bazike të moshës sipas nacionalitetit dhe gjinisë	14
Tab. 6: Pensionet kontribut paguese të moshës sipas komunave	15
Tab. 7: Pensionet kontribut paguese të moshës sipas nacionalitetit dhe gjinisë	16
Tab. 8: Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas komunave	17
Tab. 9: Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas nacionalitetit dhe gjinisë	17
Tab. 10: Skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara sipas komunave (0-18) vjeç	19
Tab. 11: Pensionet Familjare sipas komunave	20
Tab. 12: Pensionet e Invalidëve të punës sipas komunave	21
Tab. 13: Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike sipas komunave	22
Tab. 14: Skema për kompensimin e punonjësve të Arsimit për vitet 90/91 deri në vitin shkollor 98/99 sipas komunave	23
Tab. 15: Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës sipas komunave	24
Tab. 16: Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës sipas moshës	25
Tab. 17: Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës sipas kategorive	25
Tab. 18: Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës sipas nacionalitetit dhe gjinisë	26
Tab. 19: Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas komunave në Kosovës	27
Tab. 20: Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas moshës	28
Tab. 21: Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas kategorive	28
Tab. 22: Skema e pensioneve për veteranët e luftës sipas nacionalitetit dhe gjinisë	29
Tab. 23: Skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) sipas komunave	30
Tab. 24: Skema e pensioneve të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK) sipas komunave	31
Tab. 25: Skema e pensioneve të Minatorëve të Trepçës sipas komunave	32
Tab. 26: Skema e kompensimeve për personat e verbër sipas komunave	33
Tab. 27: Numri i fëmijëve të braktisur sipas komunave	34
Tab. 28: Numri i personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare të vendosur në SHPMPF dhe në shtëpitë e komunitetit	35
Tab. 29: Personat e vendosur në Institutin Special të Shtimes dhe në shtëpitë e komunitetit	36
Tab. 30: Numri i përfituesve të pensioneve dhe skemave tjera sociale	37
Tab. 31: Shuma e mjeteve të shpenzuara për pagesën e pensioneve dhe skemave tjera sociale	37

Shpjegime metodologjike

Pensionet¹

Pensioni bazik i moshës – pensioni minimal i rregullt mujor të paguar për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, që kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, pa marrë parasysh, a kanë qenë të punësuar apo jo. Shuma mujore e këtij pensioni është 90 €.

Pension kontribut pagues i moshës - është pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet, në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999.

Shuma e pensionit kontribut pagues të moshës nga muaji janar 2016 ka pësuar ndryshime ku pensionet paguhen sipas kategorizimeve në bazë të nivelit të shkollimit si në vijim :

Kategoria e parë-pensionist i pa arsimuar ose me arsim fillor – shuma e pensionit është 182 euro;

Kategoria e dytë – pensionist me arsim të mesëm- shuma e pensionit është 198 euro;

Kategoria e tretë –pensionist me arsim të lartë - shuma e pensionit është 214 euro;

Kategoria e katër –pensionist me arsim universitar- shuma e pensionit është 265 euro.

Pensionet e personave me aftësi të kufizuara – pensioni i paaftësisë së përhershme iu ofron mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me ligjin nr. 04/L-131 sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Pensionin i paaftësisë së përhershme iu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë(65) vjeç. Shuma mujore e këtij pensioni është 75 €.

Pensionet e Trepçës – Të drejtën në pension të parakohshëm e realizojnë të gjithë të punësuarit në kompleksin “Trepça” të cilët e kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004. Pensionet iu paguhen të gjithë minatorëve të kompleksit “Trepça” nëse i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara për njohjen e të drejtës në pension të parakohshëm sipas Ligjit mbi skemat pensionale të financuara nga shteti (Ligji nr.04-L-31). Shuma mujore e pagesës është 126 €.

Pensionet e Trupave mbrojtëse të Kosovës (TMK) - pension i rregullt i TMK-së është pagesa e rregullt mujore që i bëhet ish-pjesëtarit të TMK-së gjatë tërë jetës. Po ashtu përfitues nga ky pension janë trashëgimtarët- të afërmit e varur të pensionistëve të TMK-së pas vdekjes së pensionistit si bashkëshortët, fëmijët e pensionistit të TMK-së që në kohën e vdekjes së tij – saj janë nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Shuma e pagesës së pensioneve të TMK-së përcaktohet prej 60%, 70% dhe 80% të pagës mesatare.

Pension i Forcave të Sigurisë së Kosovës - është pagesa e rregullt mujore që i paguhet pjesëtarit të FSK-së i cili i plotëson kriteret e parapara në Ligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (Ligji nr.04/L-084).Përfituesit kanë të drejtë në pensionin e FSK-së, pavarësisht nga një punësim tjetër në sektorin publik ose privat, përveç nëse ata shërbejnë sërish në FSK Shuma e pagesës së pensioneve të FSK-së përcaktohet prej 60%, 70% dhe 80% të pagës mesatare.

Kompensimet për personat e verbër - I/E verbër konsiderohet personi me humbje të plotë të pamurit të lindur ose të fituar të përcaktuar sipas kriterëve mjekësore të vlerësuara nga Komisioni Mediko-social.

¹Definicionet për pensionet bazike të moshës , pensionet kontribut pagues të moshës , pensionet e personave me paaftësi të përhershme dhe pensionet e parakohshme të Trepçës janë marrë nga Ligji Nr.04-L-131.

Shuma e pagesës për personat e verbër është 125 € në muaj si dhe 125 € për shoqëruesit e personave të verbër.

Pensioni familjar² - pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me ligjin në fuqi . Të drejtën për pension familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare Shuma mujore e këtij pensioni është 90 €.

Pensioni invalidor i punës - pensioni i rregullt mujor, i paguar për personat që pësojnë lëndime në punë apo fitojnë sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj, si dhe invalidët e punës sipas Ligjit Pensionsal dhe Invalidor të aplikuar para datës 01.01.1999.

Të drejtën në pension invalidor të punës e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit invalidor, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare.

Shuma mujore e këtij pensioni është 90 €.

Pensioni për personat paraplegjik³ - nga kjo skemë përfitojnë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme.

Pensioni për personat tetraplegjik - nga kjo skemë përfitojnë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.

Shuma mujore me shoqërues është 375 € (Grupi I), kurse pa shoqërues është 150 € (Grupi II).

Pensionet për kompensimin e Arsimit për vitet 90-91 deri në vitin 98-99⁴ – pagesa ka filluar të implementohet nga muaji janar 2020.

Personi i pensionuar i cili ka punuar në arsimin shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, gëzon një kompensim shtesë për kontributin e dhënë. Përfituesit e kompensimit shtesë janë: 2.1. mësimdhënësit; 2.2. bashkëpunëtorët profesional; 2.3. drejtori dhe zëvendësdrejtori i shkollës; 2.4. personeli administrativ; 2.5. personeli teknik i shkollave; 2.6. të punësuarit në arsimin e lartë sipas sistemit të arsimit shqip.

Familjet e dëshmorëve dhe Invalidët e luftës Dëshmor i kombit⁶ - është luftëtari i UÇK-së që:

- ka rënë në luftë për lirinë e vendit;
- është plagosur në luftë për lirinë e vendit dhe ka vdekur si pasojë e plagëve të marra brenda tri (3) viteve pas përfundimit të luftës.

Invalid i luftës së UÇK-së⁵ – është luftëtari, pjesëtari dhe i internuari (burgosuri) i UÇK-së, i cili ka pësuar plagë, lëndime (dëmtime) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut, gjatë periudhës së luftës, me shkallë të invaliditetit së paku 10%. Invalidët me kujdestar (Invalidi i UÇK-së me shkallë të invaliditetit mbi 80% ka të drejtë në shtesë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër).

² Definicioni për Pensionin Familjar dhe Pënsionin invalidor të punës është marrur në Ligjin Nr.04/L-131.

³ Definicioni për Pensionet Paraplegjik dhe Tetraplegjik është marr në Ligjin Nr.05/L-067.

⁴ Definicioni për Pensionet për kompensimin e Arsimit për vitet 90-91 deri në vitin 98-99 është marr në Ligjin Nr. 06/L-073 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 9 / 26 Mars 2019).

⁵ Definicioni për invalidët e luftës dhe veteranet është marr në Ligjin Nr.04/L-172.

Veteran i luftës i UÇK-së – është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës.

Shuma e pagesës mujore për të gjitha kategoritë e skemës së DFDIL është si në vijim:

Kategoritë	Shuma e pensionit
Familjet e Dëshmorëve	
Familja qe e ka dhënë një Dëshmor:	448,13 €
Familja qe I ka dhënë dy Dëshmorë:	537,76 €
Familja qe I ka dhënë tre Dëshmorë:	582,57 €
Familja qe I ka dhënë kater Dëshmorë:	627,39 €
Familja qe I ka dhënë me shumë se 4 Dëshmorë:	672,19 €
Familjet e të zhdukurve të UÇK-së	
Familja me një të zhdukur të UÇK-se	448,13 €
Familja me dy të zhdukur të UÇK-se	537,76 €
Familja me tre të zhdukur të UÇK-se	582,57 €
Familja me kater të zhdukur të UÇK-se	627,39 €
Familja me më shumë se 4 të zhdukur të UÇK-se	672,19 €
Invalidët e Luftës	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	448,13 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	412,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	393,75 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	375,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	356,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	318,75 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	225,00 €
Invalidi me kujdestar	
Kujdestari per Invalidin me demtim trupor me mbi 80%	225,00 €
Familjet e Invalidëve të Luftës pas vdekjes	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	358,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 71- 80%	330,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 70%	315,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 51- 60%	300,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 41 -50%	285,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 31- 40%	255,00 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 20 -30%	180,00 €
Familjet e Viktimave dhe të Zhdukurve Civil	
Familja e Viktimës -të Zhdukurit Civil	168,75 €
Familja me dy Viktima - të Zhdukur	202,50 €
Familja me tre Viktima - të Zhdukur	219,38 €
Familja me katër Viktima - të Zhdukur	236,25 €
Familja me katër e më shumë Viktima -të Zhdukur	253,13 €
Invalidët Civil të Luftës	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	152,50 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 80%	136,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 40- 60%	120,00 €
Invalidi me kujdestar	
Kujdestari per Invalidin me demtim trupor me mbi 80%	50,13 €
Familjet e Invalidëve Civil të Luftës pas vdekjes	
Invalidi me dëmtim trupor mbi 80%	123,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 61- 80%	110,25 €
Invalidi me dëmtim trupor prej 40- 60%	97,25 €
Veteranet	
Veteranet Luftëtar	170,00 €
Familja e Veteranit pas vdekjes së Veteranit	119,00 €

Fëmijët e braktisur⁶

Fëmijë i braktisur pa kujdes prindëror, konsiderohet çdo fëmijë i moshës nën 18 vjeç, i cili është i braktisur nga prindërit, të cilët për shkaqe dhe arsye të ndryshme nuk i kryejnë, apo nuk janë në gjendje ti kryejnë obligimet, përgjegjësitë dhe të drejtat prindërore. Format e mbrojtjes për këtë kategori të fëmijëve janë: kujdestaria, bashkimi familjar, strehimi familjar, strehimi i përkohshëm institucional dhe adoptimi.

Shtëpia e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare (SHPMF) në Prishtinë dhe shtëpitë me bazë në komunitet (SHBK) –Për ta fituar të drejtën për vendosje në SHPMF dhe SHBK parashtruesi i kërkesës duhet t'i plotësojë këto kritere themelore: të jetë banorë i përhershëm i Republikës së Kosovës, të jetë mbi moshën 65 vjeçare, të mos ketë fëmijë biologjik apo të birësuar (vendosja – strehimi nuk pengohet nëse klienti në gjendje të nevojës ka vajzë e cila është e martuar), të jetë në gjendje të mirë psikike, të mos ketë sëmundje infektive. SHPMF dhe SHBK ofrojnë këto shërbime: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës dhe shërbime fizioterapeutike.

Instituti Special i Shtimes dhe me shtëpitë bazë me komunitet – ofrojnë këto shërbime për rezidentët: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës, edukative dhe aftësuese, trajtim social dhe terapi fizikale. Përfitues të këtyre shërbimeve janë personat me aftësi të kufizuara mendore (ngecje në zhvillimin mendor), fizike dhe të kombinuara, të cilët jetojnë të vetëm, kanë anëtarë të ngushtë të familjes, por për arsye të ndryshme janë të penguar të ofrojnë përkujdesje për anëtarin e familjes në gjendje të nevojës sociale.

Skema për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara⁷
 “Përkrahje materiale” është beneficion në formë të shumës financiare mujore ose formë tjetër e shpërblimit në të holla që administrohet nga MFPT-ja , përmes Departamentit të Politikave Sociale dhe Familjës për familje me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme. “Fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme fizike, mendore dhe shqisore” konsiderohen fëmijët nga lindja deri në moshën 18 vjeçare me vendbanim të përhershëm në Kosovë, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër. Ndhma materiale për fëmijën e me aftësi të kufizuar të përhershme paguhet në emër të prindit apo kujdestarit të fëmijës.

Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme konsiderohen:

- a) fëmijët e palëvizshëm,
- b) fëmijët plotësisht të verbër si dhe,
- c) fëmijët të cilët për shkak të natyrës së sëmundjes apo sëmundjeve të përhershme, nuk janë të aftë që në mënyrë të pavarur të lëvizin vet, në banesë, apo në vendet ku kanë nevojë, as në përdorimin e ndihmesave përkatëse, nuk janë në gjendje të ushqehen vetë, të zhvishen dhe të vishen, të kryejnë nevojat fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën e domosdoshme personale. Shuma mujore e pagesës është 100€.

⁶ Definicioni për fëmijët e braktisur është marrë në Ligjin mbi familjen dhe marrëdhëniet e familjes nr. 10/84.

⁷ Definicioni për përkrahjen materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme është marrë në Ligjin nr. 03/L-022.

Skema e ndihmës sociale⁸

Skema e ndihmës sociale ofron ndihmë të përkohshme financiare familjeve të cilat janë në varfëri dhe janë të përzgjedhura në përputhje me kriteret e parapara në ligjin nr.04/L-096 dhe në bazë të mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Kosovës.

Për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive të përcaktuara me ligj (kategoria 1 dhe 2). Përfshirë, shfrytëzues të ndihmës sociale, mund të jenë edhe shtetasit e huaj të cilët: kanë leje qëndrimi në Kosovë, personat në cilësinë e azilkërkuarit, personat në cilësinë e refugjatit dhe personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese.

Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.

Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë (i cili duhet të jetë i regjistruar si i papunësuar në Zyrën e Punësimit) dhe me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç apo që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

Shuma mujore e ndihmës sociale e cila iu paguhet familjeve në varfëri ndryshon, sa më i madh që të jetë numri i anëtarëve të familjeve si në vijim:

Familjet sipas numrit të anëtarëve	Shuma në €
Familja me një (1) anëtarë	60,00
Familja me dy (2) anëtarë	82,50
Familja me tre (3) anëtarë	90,00
Familja me katër (4) anëtarë	97,50
Familja me pesë (5) anëtarë	105,00
Familja me gjashtë (6) anëtarë	112,50
Familja me shtatë (7) anëtarë	120,00
Familja me tetë (8) anëtarë	127,50
Familja me nëntë (9) anëtarë	135,00
Familja me dhjetë (10) anëtarë	142,50
Familja me njëmbëdhjetë (11) anëtarë	150,00
Familja me dymbëdhjetë (12) anëtarë	157,50
Familja me trembëdhjetë (13) anëtarë	165,00
Familja me katërbëdhjetë (14) anëtarë	172,50
Familja me pesëmbëdhjetë (15) anëtarë	180,00

⁸ Definicioni për skemën e ndihmës sociale është marrë nga: Ligji nr.04/L-096.

Tab. 1: Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas komunave

Komuna	Muajt					
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Deçan	316	323	321	320	315	316
Gjakovë	1.054	1.051	1.064	1.076	1.071	1.080
Glllogovc	1.232	1.230	1.230	1.197	1.219	1.207
Gjilan	747	755	746	736	721	718
Dragash	426	423	405	413	395	387
Istog	363	369	364	366	366	374
Kaçanik	803	802	793	800	788	789
Klinë	921	925	931	934	938	938
Fushë Kosovë	941	941	946	954	954	964
Kamenicë	561	548	538	529	517	519
Mitrovicë	2.357	2.341	2.321	2.318	2.302	2.289
Leposaviq	376	374	378	377	383	377
Lipjan	1.368	1.317	1.330	1.340	1.320	1.318
Novobërdë	510	511	487	507	487	488
Obiliq	772	761	758	749	750	745
Rahovec	664	669	674	676	668	662
Pejë	1.055	1.066	1.073	1.079	1.080	1.079
Podujevë	963	957	953	959	937	935
Prishtinë	1.484	1.476	1.459	1.445	1.422	1.403
Prizren	783	778	768	772	758	758
Skenderaj	859	863	867	870	861	850
Shtime	368	367	353	352	350	351
Shtërpçë	278	278	264	262	257	259
Suharekë	503	498	493	487	479	483
Ferizaj	1.043	1.047	1.024	1.029	995	998
Viti	463	461	457	448	447	440
Vushtri	1.485	1.466	1.462	1.467	1.458	1.458
Zubin Potok	628	628	635	641	646	647
Zveçan	378	374	389	394	400	404
Malishevë	814	813	801	804	794	793
Junik	51	50	50	51	50	50
Mamushë	18	18	19	18	16	18
Hani i Elezit	128	128	132	132	129	131
Graçanicë	125	123	123	124	122	122
Ranillug	208	210	217	207	217	217
Partesh	59	49	49	54	53	55
Kllokot	126	124	128	124	122	120
Mitrovicë Veriore	703	697	734	726	695	702
Gjithsej	25.933	25.811	25.736	25.737	25.482	25.444

Tab. 2: Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas komunave

Komuna	Muajt					
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Deçan	1.220	1.264	1.235	1.254	1.232	1.239
Gjakovë	4.257	4.231	4.269	4.311	4.284	4.337
Gillogovc	5.405	5.390	5.378	5.229	5.344	5.288
Gjilan	2.804	2.825	2.787	2.749	2.670	2.660
Dragash	1.412	1.394	1.324	1.340	1.260	1.228
Istog	1.546	1.578	1.564	1.584	1.571	1.606
Kaçanik	3.381	3.365	3.327	3.340	3.290	3.281
Klinë	3.834	3.826	3.830	3.844	3.842	3.843
Fushë Kosovë	4.031	4.028	4.026	4.049	4.048	4.077
Kamenicë	2.166	2.102	2.056	2.007	1.968	1.980
Mitrovicë	9.646	9.561	9.457	9.471	9.383	9.330
Leposaviq	857	869	870	854	864	847
Lipjan	5.867	5.696	5.765	5.730	5.702	5.678
Novobërdë	1.660	1.673	1.614	1.677	1.616	1.626
Obiliq	3.203	3.151	3.149	3.111	3.108	3.083
Rahovec	2.774	2.797	2.813	2.825	2.790	2.775
Pejë	4.005	4.069	4.108	4.127	4.132	4.122
Podujevë	4.394	4.370	4.364	4.376	4.267	4.255
Prishtinë	5.734	5.701	5.624	5.563	5.475	5.394
Prizren	2.888	2.880	2.855	2.852	2.795	2.796
Skenderaj	3.797	3.818	3.838	3.842	3.795	3.749
Shtime	1.682	1.678	1.606	1.603	1.599	1.596
Shtërpcë	958	960	908	909	895	901
Suharekë	2.236	2.206	2.179	2.148	2.114	2.130
Ferizaj	4.273	4.268	4.179	4.172	4.016	4.025
Viti	2.002	1.995	1.958	1.921	1.927	1.898
Vushtrri	6.527	6.442	6.420	6.435	6.404	6.401
Zubin Potok	1.441	1.434	1.451	1.457	1.471	1.470
Zveçan	842	834	855	866	872	881
Malishevë	3.847	3.838	3.783	3.777	3.739	3.725
Junik	170	168	168	177	173	173
Mamushë	72	72	76	72	63	70
Hani i Elezit	532	527	543	546	536	544
Graçanicë	436	428	434	443	437	435
Ranillug	568	569	584	551	589	588
Partesh	183	145	146	165	162	169
Kllokot	423	417	439	419	408	402
Mitrovicë Veriore	1.772	1.764	1.874	1.850	1.767	1.793
Gjithsej	102.845	102.333	101.856	101.646	100.608	100.395

Tab. 3: Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas kategorive


Kategoritë	Muajt					
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	Familjet	Familjet	Familjet	Familjet	Familjet	Familjet
1	18.589	18.501	18.490	18.509	18.386	18.401
2	7.344	7.310	7.246	7.228	7.096	7.043
Gjithsej	25.933	25.811	25.736	25.737	25.482	25.444

Tab. 4: Pensionet bazike të moshës sipas komunave

Komuna	Muajt					
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Deçan	3.550	3.540	3.539	3.547	3.564	3.577
Gjakovë	7.093	7.111	7.128	7.168	7.254	7.312
Gllgovc	3.251	3.258	3.264	3.259	3.269	3.282
Gjilan	9607	9.613	9.614	9.679	9.748	9.826
Dragash	4.954	4.953	4.967	4.995	5.041	5.066
Istog	4.682	4.665	4.655	4.612	4.624	4.653
Kaçanik	2.249	2.254	2.270	2.278	2.301	2.326
Klinë	3.652	3.654	3.638	3.623	3.639	3.624
Fushë Kosovë	2.562	2.587	2.593	2.618	2.635	2.674
Kamenicë	4.406	4.404	4.384	4.397	4.436	4.456
Mitrovicë	8.110	8.150	8.182	8.253	8.312	8.373
Leposaviq	3.810	3.810	3.805	3.813	3.825	3.810
Lipjan	4.932	4.946	4.951	4.974	5.007	5.051
Novobërdë	592	587	579	584	582	583
Obiliq	1.585	1.590	1.589	1.596	1.608	1.621
Rahovec	4.098	4.101	4.105	4.129	4.132	4.182
Pejë	8.738	8.554	8.504	8.470	8.533	8.603
Podujevë	5.711	5.723	5.742	5.778	5.810	5.848
Prishtinë	15.380	15.493	15.537	15.671	15.790	15.972
Prizren	13.012	13.026	13.083	13.139	13.238	13.362
Skenderaj	3.459	3.460	3.470	3.492	3.521	3.536
Shtime	1.888	1.887	1.891	1.898	1.920	1.937
Shtërpçë	2.349	2.344	2.334	2.330	2.338	2.335
Suharekë	4.623	4.617	4.631	4.651	4.671	4.702
Ferizaj	8.223	8.238	8.269	8.302	8.360	8.464
Viti	4.030	4.028	4.019	4.043	4.051	4.094
Vushtri	4.766	4.788	4.808	4.838	4.885	4.923
Zubin Potok	1.309	1.317	1.324	1.321	1.329	1.328
Zveçan	1.532	1.541	1.539	1.545	1.545	1.531
Malishevë	3.390	3.381	3.380	3.386	3.414	3.436
Junik	-	-	-	-	-	-
Mamushë	-	-	-	-	-	-
Hani i Elezit	399	400	402	407	412	423
Graçanicë	-	-	-	-	-	-
Ranillug	-	-	-	-	-	-
Partesh	-	-	-	-	-	-
Klllokot	-	-	-	-	-	-
Mitrovicë Veriore	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	147.942	148.020	148.196	148.796	149.794	150.910

Tab. 5: Pensionet bazike të moshës sipas nacionalitetit dhe gjinisë

Muajt	Shqiptar		Të tjerë ¹⁰		Gjithsej		Gjithsej
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
Janar	40.353	80.524	12.316	14.749	52.669	95.273	147.942
Shkurt	40.514	80.628	12.235	14.643	52.749	95.271	148.020
Mars	40.667	80.783	12.171	14.575	52.838	95.358	148.196
Prill	41.009	81.106	12.141	14.540	53.150	95.646	148.796
Maj	41.468	81.583	12.167	14.576	53.635	96.159	149.794
Qershor	41.992	82.228	12.161	14.529	54.153	96.757	150.910

Fig. 1: Pensionet bazike të moshës sipas nacionalitetit në përqindje


¹⁰ Në të tjerët janë të përfshirë numri i serbëve dhe nacionaliteteve të tjera joshqiptare që jetojnë në Kosovë dhe që përfitojnë nga pensioni bazik i moshës.

Tab. 6: Pensionet kontribut paguese të moshës sipas komunave

Komuna	Muajt					
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Deçan	709	711	706	708	712	715
Gjakovë	3.970	3.981	3.993	4.009	4.031	4.049
Glllogovc	1.187	1.187	1.191	1.192	1.196	1.201
Gjilan	2140	2.135	2.145	2.154	2.180	2.195
Dragash	630	634	634	638	639	645
Istog	756	755	759	760	756	758
Kaçanik	826	827	820	824	825	831
Klinë	666	665	662	662	665	667
Fushë Kosovë	1.189	1.185	1.187	1.196	1.202	1.207
Kamenicë	590	590	591	593	597	604
Mitrovicë	3.604	3.602	3.605	3.596	3.597	3.618
Leposaviq	12	12	12	13	13	13
Lipjan	1.299	1.292	1.292	1.290	1.294	1.304
Novobërdë	37	36	36	35	35	36
Obiliq	727	730	732	733	734	740
Rahovec	784	786	786	785	791	793
Pejë	3.777	3.784	3.770	3.782	3.788	3.801
Podujevë	1.816	1.817	1.818	1.812	1.812	1.822
Prishtinë	10.281	10.280	10.281	10.300	10.307	10.346
Prizren	5.365	5.372	5.373	5.381	5.395	5.420
Skenderaj	996	995	996	994	994	997
Shtime	401	403	402	409	411	415
Shtërpçë	41	41	40	41	41	41
Suharekë	1.253	1.254	1.257	1.264	1.275	1.281
Ferizaj	2.847	2.854	2.850	2.857	2.854	2.862
Viti	632	631	631	636	640	643
Vushtrri	2.437	2.441	2.443	2.443	2.446	2.457
Zubin Potok	39	39	39	41	41	41
Zveçan	17	17	17	17	17	17
Malishevë	491	490	491	489	485	484
Junik	-	-	-	-	-	-
Mamushë	-	-	-	-	-	-
Hani i Elezit	200	200	198	198	202	204
Graçanicë	-	-	-	-	-	-
Ranillug	-	-	-	-	-	-
Partesh	-	-	-	-	-	-
Kllokot	-	-	-	-	-	-
Mitrovicë Veriore	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	49.719	49.746	49.757	49.852	49.975	50.207

Tab. 7: Pensionet kontribut paguese të moshës sipas nacionalitetit dhe gjinisë

Muajt	Shqiptar		Të tjerë ¹¹		Gjithsej		Gjithsej
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
Janar	40.047	8.684	808	180	40.855	8.864	49.719
Shkurt	40.037	8.714	813	182	40.850	8.896	49.746
Mars	39.999	8.769	804	185	40.803	8.954	49.757
Prill	40.030	8.831	805	186	40.835	9.017	49.852
Maj	40.087	8.899	803	186	40.890	9.085	49.975
Qershor	40.228	8.985	807	187	41.035	9.172	50.207

Fig. 2: Pensionet kontribut pagues të moshës sipas nacionalitetit në përqindje


¹¹ Në të tjerët janë të përfshirë numri i serbëve dhe nacionaliteteve të tjera joshqiptare që jetojnë në Kosovë dhe që përfitojnë nga pensioni kontribut pagues i moshës.

Tab. 8: Pensionet e personave me aftësi të kufizuara sipas komunave

Komuna	Muajt					
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Deçan	303	291	290	292	299	316
Gjakovë	1.036	1.027	1.038	1.114	1.074	1.106
Glogovc	422	413	417	422	418	425
Gjilan	1.076	1.114	1.114	1.165	1.138	1.187
Dragash	315	309	311	333	326	338
Istog	415	412	405	406	398	398
Kaçanik	321	320	320	342	339	343
Klinë	378	372	369	377	370	381
Fushë Kosovë	367	362	356	371	365	366
Kamenicë	343	347	347	377	371	390
Mitrovicë	1.277	1.306	1.244	1.319	1.324	1.317
Leposaviq	118	115	100	109	106	101
Lipjan	629	627	636	658	658	667
Novobërdë	32	33	32	34	32	33
Obiliq	177	184	192	198	188	190
